

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFZUAR
"A&A AIRPORT" sh.p.k.**

Sot, me date 16/04/2018, ne Tirane, u hartua ky akt themelimi nga Zj. Alselda Kosturi, shtetase shqiptare, e bija e Seitit dhe Bukuries, dtl. 28.07.1981, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ne cilesine e ortakut themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar si me poshte vijon:

**Neni 1
Themelimi dhe Emri i Shoqerise**

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "A&A AIRPORT" sh.p.k. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit te saj si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Shoqeria e ka seline e saj ne Adresen: Qarku Durres, Komuna Nikel, RINAS Kruje, Fshati Rinas, Aeroporti Nderkombetar "Nene Tereza" dhe mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Shoqeria eshte person juridik privat shqiptar, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

**Neni 2
Objekti i Shoqerise**

Objekti kryesor i shoqerise eshte:

- Import – eksport, prodhim dhe tregti suveniresh;
- Bar – Kafé dhe sherbime qe lidhen me keto veprimtari;
- Import – eksport dhe tregtimi i kafes, pijeve dhe produkteve te tjera ushqimore;
- Restorante, fast food sherbim, prodhim, catering, dyqane dhe sherbime qe lidhen me keto veprimtari;
- Import – eksport dhe tregti te ndryshme.

Shoqeria mundet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Ajo mund te shtoje objektin dhe te hape veprimtari te reja si brenda dhe jashte vendit.

Shoqeria mund te krijojë, rrise apo te pakesoje numrin e degeve, filialeve, agjensive dhe zyrave te përfaqesimit ne varesi te saj, brenda dhe jashte vendit.

Shoqëria mund të marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja.

Shoqeria mund te kryeje cdo veprim me qellim marrjen e lejeve, autorizimeve, licensave dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarive te saj, per te cilat kerkohen dokumenta administrative.

Objekti i shoqerise mund te ndryshoje me vendim te asamblese se ortakeve, duke ruajtur ne momentin konkret pershtatjen me dispozitat ligjore ne fuqi.

**Neni 3
Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat te caktuar.

**Neni 4
Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 (njqindmije) leke dhe eshte i ndare ne 1 (nje) kuote me vlere nominale 100,000 (njqindmije) leke. I gjithë kapitali themeltar eshte derdhur, paguar dhe nenshkruar teresisht ne pjese te barabarta nga ortaku themelues Zj. Alselda Kosturi.

Kuotat jane nominale dhe mund te transferohen vetem sipas percaktimeve te nenit 6 te statutit te shoqerise.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e shoqerise.

Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet, ne menyren dhe formen e parashikuar me ligj.

**Neni 5
Ushtrimi financiar i Shoqerise**

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne ditën e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor 2018.

**Neni 6
Organet drejtuese**

Organet drejtuese te Shoqerise jane Asambleja e Ortakeve dhe Administratoret.

**Neni 7
Perberja e Asamblese**

Asambleja e pare e Ortakeve perbehet nga ortaku themelues i saj qe eshte Zj. Alselda Kosturi.

**Neni 8
Administrimi i shoqerise**

Rregullat per funksionimin, drejtimin dhe pergjegjesite e shoqerise jane te percaktuara ne Statutin e shoqerise qe shoqeron kete Akt Themelimi.

Administratori i shoqerise eshte Z. Adrian Kosturi.

Ky Akt i Themelimit te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar perpilohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe.

ORTAKU THEMELUES
Zj. Alselda Kosturi